



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1635 / Prot.
3

Tiranë, më 21 . 7 .2022

V E N D I M

Nr. 15, datë 20 . 07 .2022

“Për dhënien e titullit “Profesor Emeritus”, Prof. Aleko Minga”

Bazuar në nenet 38 dhe 61 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 31, germa th), të Statutit të UT-së; në kreun V, pika 2, të VKM-së nr. 112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, si dhe pas dhënies së pëlqimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 4276/1 prot., datë 15.07.2022, mbi propozimin e bërë nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës me shkresën nr. 277/3 prot, datë 26.05.2022, në mbledhjen e datës 20.07.2022, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. T’i jepet titulli “Profesor emeritus”, Prof. Aleko Minga me motivacionin:

“Për merita të shquara profesionale, njerëzore dhe qytetare, për përkushtimin dhe pasionin në edukimin e brezave të rinj në fushën e matematikës, si dhe për kontributin e çmuar në pasurimin e mendimit filozofik e matematikor, përmes veprave, kumtesave, referimeve, botimeve, auditoreve të hapura, duke i dhënë një tjetër dimension zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri”.

2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Prof. Dr. Artan Hoxha
